VENDIM
Nr. 139, datë 8.3.2023

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, DHE KfW *FRANKFURT AM MAIN* (KFW), E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH), (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT), MASAT SHOQËRUESE PËR PROJEKTIN "ZHVILLIMI I INTEGRUAR RAJONAL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW *Frankfurt am Main* (KfW), e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), (Agjencia e zbatimit të projektit), masat shoqëruese për projektin "Zhvillimi i integruar rajonal", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE GRANTI

DATË 29 DHJETOR 2022
NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN ("KfW") DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ("MARRËSI") TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH) ("AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT") PËR SHUMËN 1,000,000.00 EURO
- MASAT SHOQËRUESE PËR PROJEKTIN "ZHVILLIMI I INTEGRUAR RAJONAL"
- BMZ - NR. 2018 70 054

Përmbajtja

Neni
1. Shuma dhe qëllimi i grantit
2. Kanalizimi i grantit për Agjencinë e Zbatimit të Projektit
3. Disbursimi
4. Pezullimi i disbursimeve dhe ripagimi
5. Kostot dhe tarifat publike
6. Marrëveshjet kontraktuale dhe prokura
7. Shërbimet e ekspertëve
8. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me shërbimet e ekspertëve
9. Dispozita të ndryshme
Zotimet e përputhshmërisë së Përfituesit
Zotimet e Përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit

Në bazë të marrëveshjes së datës 27 janar 2021 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar

("Marrëveshja Qeveritare"), Përfituesi dhe KfW-ja lidhin marrëveshjen e mëposhtme të grantit ("Marrëveshja" ose "Marrëveshja e Grantit").

Kjo Marrëveshje Granti dhe marrëveshja e huas ("Marrëveshja e Huas") e së njëjtës datë financojnë Projektin (sipas përcaktimit më poshtë).

1. Shuma dhe qëllimi i Grantit

1.1 KfW-ja i ofron Marrësit një grant deri në shumën 1,000,000.00 euro (me fjalë: një milion euro) ("Granti").

Granti nuk është i ripagueshëm, përveçse kur parashikohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Marrësi e kanalizon të plotë Grantin për Agjencinë e Zbatimit të Projektit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit e përdor Grantin vetëm për shërbimet e ekspertëve për masën shoqëruese të Projektit ("Shërbimet e ekspertëve") dhe për të paguar kryesisht kostot e këmbimit valutor. Detajet dhe objekti i shërbimeve të ekspertëve, që do të financohen nga Granti, do të përcaktohen me marrëveshje të veçantë, lidhur midis Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së, e cila do të nënshkruhet sikurse lexohet dhe dakordësohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, që përfaqëson Marrësin ("Marrëveshja e veçantë").

1.3 Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë në mënyrë të detajuar kontributet homologe që do të sigurohen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit në Marrëveshjen e veçantë, e cila do të firmoset sikurse është lexuar dhe rënë dakord nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, që përfaqëson Marrësin. Agjencia e Zbatimit të Projektit i dorëzon kontributet homologe të plota dhe në kohën e duhur. Agjencia e Zbatimit të Projektit i jep KfW-së, sipas kërkesës, evidencat që vërtetojnë masat e marra për këtë qëllim.

1.4 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të mbulohen nga Marrësin ose Agjencia e Zbatimit të Projektit, si edhe tarifat e importit nuk financohen nga Granti.

2. Kanalizimi i Grantit për Agjencinë e Zbatimit të Projektit

2.1 Marrësi e kanalizon Grantin për Agjencinë e Zbatimit të Projektit në formën e një granti të paripagueshëm, sipas një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2 Përpara disbursimit të parë nga Granti, Marrësi i paraqet KfW-së përkthimin e certifikuar të marrëveshjes së përmendur në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i Grantit nuk përbën asnjë detyrim të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës në kuadër të kësaj Marrëveshjeje.

3. Disbursimi

3.1 KfW-ja e disburson Grantin në përputhje me progresin e shërbimeve të ekspertëve dhe me kërkesë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë në Marrëveshjen e veçantë procedurën e disbursimit dhe në veçanti evidencat që vërtetojnë se fondet e kërkuara janë përdorur për qëllimin e parashikuar.

3.2 KfW-ja ka të drejtë të refuzojë t'i bëjë disbursimet pas datës 30 qershor 2028.

4. Pezullimi i disbursimeve dhe ripagimi

4.1 KfW-ja nuk mund t'i pezullojë disbursimet, përveçse, kur:

a) Marrësi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për pagesat kur kërkohet kryerja e tyre,

b) detyrimet në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes së Huas ose të marrëveshjes së veçantë, ose marrëveshjeve të tjera të lidhura me këtë Marrëveshje nuk janë përmbushur,

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të provojë se shumat e disbursuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje shkel ligjin e zbatueshëm; ose

e) shfaqen rrethana të jashtëzakonshme, që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht lëvrimin ose qëllimin e shërbimeve të ekspertëve.

4.2 Nëse ka ndodhur ndonjë prej situatave të specifikuara në nenin 3.1/b, "c" ose "d" dhe nuk është eliminuar brenda periudhës së përcaktuar nga KfW-ja, që megjithatë është të paktën 30 ditë, KfW-ja mund:

a) në rastin e përcaktuar në nenin 3.1/b ose d, të kërkojë ripagim të menjëhershëm të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e përcaktuar në nenin 3.1/c, të kërkojë ripagimin e menjëhershëm të këtyre shumave kur Marrësi nuk arrin të provojë se këto shuma janë përdorur për qëllimin e parashikuar.

5. Kostot dhe tarifat publike

Marrësi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që lindin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë lidhur me përmbylljen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transfertave dhe konvertimit që lindin lidhur me disbursimin e Grantit.

6. Marrëveshjet kontraktuale dhe prokura

6.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë përfaqëson Marrësin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe personat e caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar me anë të modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj, përfaqësojnë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje dhe zbatimin e Projektit dhe kësaj Marrëveshjeje. Prokurat nuk skadojnë deri në marrjen nga ana e KfW-së të revokimit të tyre nga përfaqësuesi i autorizuar në atë kohë.

6.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje, si dhe njoftimet apo deklaratat e lëshuara nga palët kontraktuale në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje bëhen me shkrim. Ministri i Financave dhe Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje që prekin vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 3.2) nuk kërkohen që të miratohen paraprakisht nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë konsiderohet e marrë menjëherë pasi të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuale përkatëse, ose në adresa të tjera të palës kontraktuale përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuale:

Për KfW-në:	KfW Postfach 11 11 41 60046 Frankfurt am Main Republika Federale e Gjermanisë Faks: +49 69 7431-2944
Për Marrësin:	Republika e Shqipërisë Ministria e Financave dhe Ekonomisë Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3 1001 Tiranë, Shqipëri
Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit Rr. "Sami Frashëri", 10 Tiranë, Shqipëri Telefon: +355 4234 885 Faks: +355 4234 885

Amendamentet e kësaj Marrëveshjeje që prekin vetëm marrëdhëniet ligjore ndërmjetë KfW-së dhe Marrësit nuk kërkojnë miratimin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

7. Shërbimet e ekspertëve

7.1 Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) përgatit dhe lëvron shërbimet e ekspertëve në përputhje me praktikat e shëndosha financiare dhe inxhinierike, standardet mjedisore dhe sociale, si dhe veçanërisht në përputhje me konceptin e dakordësuar midis Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së për shërbimet e ekspertëve, dhe për këtë qëllim përdor shërbimet e inxhinierëve konsultues të pavarur dhe të kualifikuar;

b) përmbush kurdoherë dispozitat e prokurimit të parashikuara në Marrëveshjen e veçantë duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

c) mban ose siguron mbajtjen e librave, regjistrave dhe llogarive të sakta dhe të rregullta, duke treguar në mënyrë transparente të gjitha kostot e shkaktuara në lidhje me shërbimet e ekspertëve dhe identifikuar qartësisht mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky grant financiar;

d) u mundëson përfaqësuesve të KfW-së që të inspektojnë në çdo kohë librat dhe regjistrat, si dhe çdo dokumentacion tjetër përkatës që lidhet me lëvrimin e shërbimeve të ekspertëve;

e) i jep KfW-së çdo informacion dhe raport mbi shërbimet e ekspertëve dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së.

7.2 Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë përkatëse të nenit 7.1 përmes Marrëveshjes së veçantë, e cila firmoset gjithashtu siç lexohet dhe dakordohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, që përfaqëson Marrësin.

7.3 Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit, do të:

a) sigurojnë financimin e plotë të shërbimeve të ekspertëve dhe, me kërkesë, i vënë në dispozicion KfW-së evidenca që vërtetojnë mbulimin e të gjitha kostove të papaguara nga Granti;

b) me nismën e vet, informon në kohë KfW-në për çdo rrethanë që pengon ose rrezikon seriozisht zbatimin e shërbimeve të ekspertëve ose qëllimin e tyre.

7.4 Marrësi e ndihmon Agjencinë e Zbatimit të Projektit në përputhje me praktikat e shëndosha inxhinierike dhe financiare në zbatimin e Projektit dhe në përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, dhe në veçanti, i jep Agjencisë së Zbatimit të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Projektit.

8. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me shërbimet e ekspertëve

8.1 Për të përmbushur parimet e pranuara në rang ndërkombëtar për arritjen e transparencës dhe efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja e bën publik informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe kategorizimit mjedisor dhe social, si dhe raportet e vlerësimit *ex post)* për shërbimet e ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë negociatave parakontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjeve të lidhura me shërbimet e ekspertëve dhe me fazën paskontraktuale (në vijim referuar si "**Periudha e plotë**").

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për fushën e tij të biznesit "Banka e Zhvillimit KfW" (http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/).

Publikimi i informacionit (qoftë nga KfW-ja apo palët e treta në përputhje me nenin 8.3 më poshtë) për shërbimet e ekspertëve dhe mënyrës së tyre të financimit nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të hollësishëm, delikat financiar apo të lidhur me biznesin rreth palëve të përfshira në shërbimet e ekspertëve ose në financimin e tyre, si:

a) informacion për të dhëna të brendshme financiare;

b) strategji biznesi;

c) udhëzime dhe raporte të brendshme;

d) të dhëna personale të personave fizikë;

e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për pozicionin financiar të palëve.

8.2 KfW-ja e ndan informacionin e përzgjedhur për shërbimet e ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë periudhës së plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht, për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

a) degët e KfW-së;

b) Republika Federale e Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë apo subjektet kompetente;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin e zhvillimit dypalësh gjerman, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;

d) organizatat ndërkombëtare të angazhuara në mbledhjen e të dhënave statistikore, dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe anëtarët e saj;

e) Agjencia e Zbatimit të Projektit.

8.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për shërbimet e ekspertëve dhe mënyrës së tyre të financimit përgjatë periudhës së plotë me subjektet e mëposhtme, që botojnë artikuj që kanë lidhje me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Iniciativës Ndërkombëtare të Transparencë së Ndihmës (https://www.bmz.de/de/ministerium/zahlen-fakten/internationale-transparenzstandards-59280);

b) Tregu dhe Investimi Gjerman (GTAI) për qëllimet e informacionit për tregun (https://www.gtai.de/gtai-de/trade);

c) OECD-ja për qëllimet e raportimit të flukseve financiare në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (http://stats.oecd.org/);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval) për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim për të siguruar transparencë dhe efikasitet (http://www.deval.org/de/).

8.4 KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për shërbimet e ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë periudhës së plotë te palët e tjera të treta për të mbrojtur interesat e ligjshme.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta, nëse interesat e ligjshme të Marrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit në informacionin që nuk transferohet i tejkalon interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshme të Përfituesit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit përfshijnë veçanërisht konfidencialitetin e informacionit sensitiv, të përmendur në nenin 8.1 që përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion për palët e treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave ligjore ose rregulloreve, ose për të mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë apo procedime administrative.

9. Dispozita të ndryshme

9.1 Marrësi merr përsipër të përmbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcë *(Akti i përputhshmërisë së Përfituesit)*. Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të përmbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcën 1b *(Akti i përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit)*.

9.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej kësaj plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit mund të mos caktojnë ose transferojnë, zotojnë ose hipotekojnë asnjë pretendim nga kjo Marrëveshje.

9.4 Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligjet e Republikës Federale Gjermane. Vendi i zbatimit do të jetë Frankfurt am Main.

9.5 Marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Marrësit të përcaktuara në këtë Marrëveshje, përfundojnë gjashtë vjet pas disbursimit të fundit.

9.6 Kjo Marrëveshje Financimi nuk hyn në fuqi dhe nuk ka efekt derisa Marrësi të informojë KfW-në me shkrim se procedurat e brendshme ligjore që duhen kryer nga ai vetë kanë përfunduar (data e marrjes në KfW). KfW-ja do të informojë Marrësin për marrjen përkatëse të njoftimit.

Hartuar në 3 (tri) kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main, 29 dhjetor 2022

KfW

_____

Emri: Arne Goss
Titulli: Shefi i Departamentit të Infrastrukturës Bashkiake Evropa Juglindore dhe Turqia

Tiranë, _____

Republika e Shqipërisë
Përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

_____

Emri: Delina Ibrahimaj

Titulli: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

_____

Emri: Brit Horschke
Titulli: Drejtori i vendit për Shqipërinë i KfW

_____

Emri: Dritan Agolli
Titulli: Drejtor ekzekutiv

Shtojcat:
Zotimet e përputhshmërisë së Marrësit
Zotimet e përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit

SHTOJCA 1.A
ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË SË MARRËSIT

1. PËRKUFIZIME

"Praktikë shtrënguese", dëmtimi apo lëndimi, ose kërcënimi për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e atij personi.

"Praktikë e fshehtë" është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

"Praktikë korruptive", premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo pagese të paligjshme ose avantazhi i papërshtatshëm i çdo natyre, ndonjë personi ose nga ndonjë person, me qëllim ndikimin në veprimet e ndonjë personi ose që shkaktojnë që ndonjë person të përmbahet nga ndonjë veprim i caktuar.

"Praktikë mashtruese", çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin që me vetëdije ose nga pakujdesia mashtron ose synon të mashtrojë një person për të marrë përfitim financiar ose për të shmangur një detyrim.

"Praktikë penguese": i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja me qëllim e materialit të provave për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar në akuzat për një praktikë korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi i çdo pale për të parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështjet që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii) veprime me qëllimin për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar me kontratë në lidhje me hetimin zyrtar në akuzat e një praktike korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

"Person", çdo person fizik, person juridik, ortakëri ose shoqatë e pathemeluar.

"Praktikë e sanksionueshme", çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktikë mashtruese ose praktikë penguese (siç janë përcaktuar në këtë Marrëveshje), e cila: i. është e paligjshme sipas ligjit gjerman ose ndonjë ligji tjetër të zbatueshëm; dhe ii. ka ose mund të ketë një efekt material ligjor ose reputacional në Marrëveshjen ndërmjet Marrësit dhe KfW-së ose te zbatimi i saj.

"Sanksione", ligjet, rregulloret, embargot ose masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, të miratuara ose të zbatuara nga ndonjë organ sanksionues.

"Organ sanksionues", cilido nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

"Listë e sanksioneve", çdo listë e personave, grupeve ose subjekteve të caktuara posaçërisht, të cilat janë objekt i sanksioneve të lëshuara nga ndonjë organ sanksionues.

2. SIPËRMARRJA PËR INFORMIM

Marrësi:

a) i vë në dispozicion KfW-së në kohë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin përkatës që ka të bëjë me njohjen e klientit apo informacione të ngjashme për Marrësin;

b) i ofron KfW-së, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet mbi shërbimin e ekspertëve të Marrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktore apo palëve të tjera përkatëse, te të cilat KfW-ja mbështetet për të përmbushur detyrimet e saja për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimin e parave, dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së punës me Përfituesin, që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në në kohë dhe me nismën e tij sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me shërbimet e ekspertëve;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi shërbimet e ekspertëve dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) i mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj inspektimin në çdo kohë të dokumentacionit të Marrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktore apo palëve të tjera të lidhura me të mbi shërbimet e ekspertëve dhe kryerjen e vizitave për shërbimet e ekspertëve dhe të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

3. DEKLARIME DHE GARANCI

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman apo legjislacionit të vendit të Marrësit, Marrësi deklaron se asnjë prej personave që vepron në emër të Marrësit për shërbimet e ekspertëve nuk ka kryer apo nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim të terrorizmit.

3.2 Deklarimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen bëhet për herë të parë nëpërmjet ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje. Ato konsiderohen si të përsëritura me çdo tërheqje të Grantit duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

4. SIPËRMARRJE POZITIVE

Marrësi merr përsipër të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, sapo Marrësi apo KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim të terrorizmit, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Në veçanti, Marrësi i përgjigjet në kohë dhe hollësisht çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje me dokumente për këtë përgjigje me kërkesë të KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Marrësi nuk kryen transaksione apo nuk angazhohet në veprimtari të tjera lidhur me shërbimet e ekspertëve që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

SHTOJCA 1.B
ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË SË AGJENCISË SË ZBATIMIT TË PROJEKTIT

1. PËRKUFIZIME

“Praktikë shtrënguese”, dëmtimi apo lëndimi, ose kërcënimi për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e atij personi.

“Praktikë e fshehtë” është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

“Praktikë korruptive”, premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo pagese të paligjshme ose avantazhi i papërshtatshëm i çdo natyre, ndonjë personi ose nga ndonjë person, me qëllim ndikimin në veprimet e ndonjë personi ose që shkaktojnë që ndonjë person të përmbahet nga ndonjë veprim i caktuar.

“Kategoritë e përcaktuara të shkeljeve”, kategoritë e mëposhtme të shkeljeve, të përkufizuara sipas rekomandimeve të FATF-së dhe shënimeve përkatëse interpretuese:

pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe shantazhim; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi i emigrantëve; shfrytëzimi seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope; trafikimi i paligjshëm i armëve; trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhura dhe mallrave të tjera; korrupsioni dhe mitëmarrja/mitëdhënia; mashtrimi; falsifikimi i parave; falsifikimi dhe pirateria e produkteve; krimi mjedisor; vrasja, lëndimi i rëndë trupor; rrëmbimi; mbajtja me forcë dhe pengmarrja; grabitja dhe vjedhja; kontrabandimi (duke përfshirë edhe në lidhje me taksat e tarifat doganore dhe akcizat); krimet tatimore (lidhur me taksat direkte dhe indirekte); zhvatja; falsifikimi, pirateria; manipulimi i tregut dhe tregtimi i brendshëm.

"Rekomandimet e FATF-së", këto rekomandime, siç përkufizohen herë pas here nga Grupi i Posaçëm për Veprimin Financiar (FATF). FATF-ja është një organ ndërqeveritar, qëllimi i të cilit është zhvillimi dhe promovimi i politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

"Praktikë mashtruese", çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin që me vetëdije ose nga pakujdesia mashtron ose synon të mashtrojë një person për të marrë përfitim financiar ose për të shmangur një detyrim.

"Burim i paligjshëm", burimi i fondeve të siguruara përmes:

a) shkeljeve të renditura në kategorinë e përcaktuar të shkeljeve;

b) çdo praktikë korruptive;

c) çdo praktikë mashtruese; ose

d) pastrimit të parave.

"Praktikë penguese": i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja me qëllim e materialit të provave për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar në akuzat për një praktikë korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi i çdo pale për të parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështjet që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii) veprime me qëllimin për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar me kontratë në lidhje me hetimin zyrtar në akuzat e një praktike korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

"Person": çdo person fizik, person juridik, ortakëri ose shoqatë e pathemeluar.

"Praktikë e sanksionueshme", çdo praktikë kanosëse, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktike mashtruese ose praktike penguese (sipas termave të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: i) është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme; dhe që ii) ka, ose mund të ketë efekt material ligjor ose të lidhur me reputacionin mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Marrësit dhe KfW-së apo zbatimi të saj.

"Sanksione", ligjet, rregulloret, embargot ose masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, të miratuara ose të zbatuara nga ndonjë organ sanksionues.

"Organ sanksionues", cilido nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

"Listë e sanksioneve", çdo listë e personave, grupeve ose subjekteve të caktuara posaçërisht, të cilat janë objekt i sanksioneve të lëshuara nga ndonjë organ sanksionues.

2. SIPËRMARRJA PËR INFORMIM

Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) i vë në dispozicion KfW-së në kohë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që ka të bëjë me njohjen e klientit apo informacione të ngjashme për Agjencinë e Zbatimit të Projektit dhe aksionarët (të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë), filialet dhe/ose ortakët e tjerë të saj (nëse ka);

b) i ofron KfW-së në kohë, sipas kërkesës, përmes Agjencisë së Zbatimit të Projektit, të gjithë informacionin dhe dokumentet mbi Projektin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të

saj (nën)kontraktore apo palëve të tjera përkatëse, te të cilat KfW-ja mbështetet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimin e parave, dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së punës me Agjencinë e Zbatimit të Projektit, që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në në kohë dhe me nismën e saj, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, anëtarët e organeve të saj të menaxhimit, organeve të tjera qeverisëse apo aksionarëve të saj;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) i jep mundësinë KfW-së dhe agjentëve të vet të inspektojnë kurdoherë të gjithë dokumentacionin e lidhur me Projektin të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe (nën)kontraktorëve të saj dhe palëve të lidhura, dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet përkatëse për qëllimet e kësaj shtojce;

f) informon KfW-në në kohë dhe me nismën e saj për çdo ngjarje që mund të sjellë klasifikimin ekzistues ose të mundshëm të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, anëtarëve të organeve të saj të menaxhimit ose organeve të tjera qeverisëse apo të aksionarëve të saj, si shtetas me emërtim të veçantë, ose persona apo subjekte të bllokuara, të renditur në çfarëdo lloj liste sanksionesh.

3. PËRFAQËSIM DHE GARANCI

3.1 Në përputhje me ligjin gjerman dhe ligjin e vendit të regjistrimit ligjor të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, Agjencia e Zbatimit të Projektit përfaqëson dhe garanton vërtetësinë dhe saktësinë e të mëposhtmeve:

a) në lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emrin e saj dhe për llogari të vet;

b) në dijeni të saj dhe vetëm në lidhje me aksionarët që njihen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit sipas rregulloreve të zbatueshme të bursës, as kapitali i Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe as fondet e investuara në Projekt nuk kanë burim të paligjshëm;

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit, ortakët, filialet apo asnjë person tjetër që vepron në emër të saj nuk ka kryer apo nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim të terrorizmit;

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit, nuk: i) ka lidhur ndonjë marrëdhënie pune me shtetas me emërtim të veçantë apo persona dhe subjekte të bllokuara, të renditur në çfarëdo lloj liste sanksionesh; ose nuk ii) është angazhuar në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

3.2 Sigurimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato konsiderohen si të përsëritura me çdo tërheqje të Grantit duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

4. SIPËRMARRJE POZITIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit merr përsipër:

a) të përmbushë plotësisht standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me rekomandimet e FATF-së dhe të zbatojë, respektojë dhe përmirësojë, nëse është e nevojshme, standardet dhe udhëzimet e brendshme (duke përfshirë pa kurrfarë kufizimi kujdesin ndaj klientit), të nevojshme për shmangien e praktikave të sanksionueshme, akteve të pastrimit të parave, ose financimin e terrorizmit; dhe

b) sapo Agjencia e Zbatimit të Projektit ose KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim të terrorizmit, të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Agjencia e Zbatimit të Projektit i përgjigjet në kohë dhe hollësisht çdo njoftimi të KfW-së në veçanti dhe ofron mbështetje në dokumente për këtë përgjigje me kërkesë të KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit merr përsipër:

a) të garantojë që kapitali dhe fondet e tjera që investon të mos jenë të një origjine të jashtëligjshme;

b) të sigurojë se proceset e saj të punës nuk lënë vend për praktika të sanksionueshme, pastrim parash apo financim të terrorizmit; dhe

c) të mos lidhë apo të mos çojë më tej asnjë marrëdhënie pune me shtetas me emërtim të veçantë apo persona dhe subjekte të bllokuara, të renditur në çdo listë sanksionesh; ose të mos angazhohet në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.